



BANKA E SHQIPËRISE

KONFERENCË PËR SHTYP

e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë

z. Shkëlqim Cani

"Zhvillimet e fundit në treguesin e inflacionit dhe ecuria e pritshme e çmimeve në muajin dhjetor".

Tiranë, më 26 nëntor 2002

Të nderuar gazetarë, përfaqësues të medias!

Sipas traditës dhe Rregullores së Trasparencës së Bankës së Shqipërisë mbaj këtë konferencë për shtyp për të trajtuar zhvillimet kryesore në çmimet e konsumit gjatë vitit 2002, faktorët që ndikuan në to, qofshin këto të zakonshëm ose të paparashikuar si dhe pritshmërinë për ecurinë e mëtejshme të çmimeve.

Objektivi i Bankës së Shqipërisë i përcaktuar për vitin 2002 ishte mbajtja e normës së inflacionit në fund të vitit brenda intervali 2 deri në 4 për qind. Ky objektivi përfaqëson një synim afatmesëm të Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, faktorët që ndikuan në ecurinë e çmimeve të konsumit gjatë gjithë vitit 2002 ushtruan presion për rritje të inflacionit dhe për pasojë është vështirësuar shkallën e përmbushjes së këtij objektivi. Muaji dhjetor gjithnjë është shfaqur me mjaft surpriza të pakëndshme në drejtim të nivelit të çmimeve të konsumit, efekti negativ i të cilave shumëfishohet si pasojë e veprimeve spekulative në treg. Gjithsesi, Banka e Shqipërisë në përputhje me pritshmëritë e saj (pa ndonjë zhvillim surprize), vleron se niveli i inflacionit në fund të vitit 2002, do të jetë rreth 4 për qind, afër kufirit të sipërm të intervalit objektiv.

Faktorët që kanë ndikuar gjatë vitit 2002 kanë qenë me veprim të dyfishtë: nga kahu i ofertës dhe i kërkesës. Ky dallim bëhet pasi në bazë të natyrës së faktorit që ndikon, përcaktohet nëse duhet të reagohet me vendime të politikës monetare apo jo. Si rregull i përgjithshëm, politika monetare është aktive në drejtim të ndryshimit të normës së interesit, nëse vëren që faktorët apo presionet vijnë nga kahu i kërkesës: më shumë para në qarkullim, nënçmim i monedhës së vendit etj. Nëse faktorët janë të krahut të ofertës, për shembull rritje apo liberalizim i çmimeve të administruara, ato përfaqësojnë goditje të cilat edhe pse shkaktojnë rritje të inflacionit, gjykohet se ndikimi i tyre është i njehershëm pa fuqi prapavepruese në periudhat që pasojnë. Ndaj ndryshimeve të tilla të çmimeve si rregull politika monetare nuk duhet të reagoj. Megjithatë, në vitin

2002 ka qenë fakt që faktorët e ofertës kanë vepruar njëri pas tjetrit duke u shndërruar në një faktor me ndikim më afatgjatë mbi inflacionin.

Në pjesën e parë të vitit u evidentuan të paktën dy rreziqe kryesore për arritjen e objektivit të inflacionit:

- kriza energjitike;
- shqetësimet në lidhje me realizimin e objektivit të rritjes ekonomike, sidomos në degën e bujqësisë.

Përveç këtyre faktorëve, në vitin 2002 inflacioni u publikua në bazë të shportës së re të mallrave e cila kishte ndryshime në peshat e grupeve dhe zërave përbërës si dhe përfshinte 41 artikuj më tepër, të pamatur më parë. Këto ndryshime krijuan një faktor shtesë me ndikim në inflacion, i cili në raportet e Bankës së Shqipërisë është emërtuar "efekti statistikor". Përvoja, si ajo botërore ashtu edhe ajo shqiptare, tregon se në momente të tilla të ndryshimeve të matjes së treguesve të ekonomisë reale, krijohen disa luhatje të pazakonta. Me kalimin e kohës, matja fiton konsistencë dhe ecuri normale të llogaritjes.

Gjithashtu, në janar të vitit 2002 hyri në qarkullim fizikisht monedha e përbashkët e 12 vendeve europiane, euro. Është vlerësuar që kjo dukuri ndikoi në rritje të inflacionit të vendeve të Eurozonës, vende të cilat përfaqësojnë partnerin kryesor tregtar për Shqipërinë. Për pasojë, në kushte të tjera të pandryshueshme, inflacioni që importohet nëpërmjet blerjes së mallrave dhe të shërbimeve në Eurozonë ishte më i lartë.

Faktorëve të njohur që në fillim të vitit për presionin që do të ushtronin në rritje të inflacionit iu shtuan edhe të tjerë të paparashikuar si: tërheqja e depozitave nga paniku i përhapur në dy bankat më të mëdha të vendit në pranverën e këtij viti dhe përmbytjet e e muajit shtator të cilët dëmtojnë prodhimin bujqësor e blegtoral dhe shkurtuan stinën turistike.

1. INFLACIONI DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË ATË


Në fund të muajit tetor 2002 Indeksi i Çmimeve të Konsumit ka arritur në vlerën 98.89. Në nivel vjetor, norma e inflacionit është 6.1 për qind ndërkohë që si normë vjetore mesatare ajo qëndron në nivelin 5.8 për qind. Këto shifra nuk përfaqësojnë as vlerat më të larta dhe as vlerat më të ulta të inflacionit vjetor gjatë vitit 2002. Në mënyrë të vazhdueshme inflacioni ka qenë jashtë intervalit objektiv dhe mbi kufirin e sipërm të tij. Niveli më i lartë u arrit në muajin shkurt me 7.7 për qind ndërkohë që inflacioni ra nën 4 për qind në një muaj të vetëm, në qershor.

Tabelë : Norma vjetore e inflacionit.

	1999	2000	2001	2002
Janar	6.0	-1.3	2.2	6.5
Shkurt	3.5	-1.3	1.5	7.7
Mars	2.0	-2.1	2.9	7.6
Prill	0.4	-1.4	3.0	6.6
Maj	-0.1	-0.1	2.5	4.6
Qershor	-0.6	0.1	4.0	3.8
Korrik	0.1	-1.3	5.6	4.3
Gusht	-0.6	-0.7	4.1	5.5
Shtator	-1.9	0.9	3.5	5.4
Tetor	-1.8	1.8	1.8	6.1
Nentor	-1.2	1.9	2.8	
Dhjetor	-1.0	4.2	3.5	

Në përgjithësi, gjatë vitit 2002 ecuria e normës së inflacionit ka qenë atribut i ndikimit të dy grupeve me peshë më të madhe, grupit "ushqim dhe pije joalkolike" dhe grupit "qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji". Megjithatë, edhe në grupet e tjera janë vërejtur lëvizje të ndjeshme të nivelit të çmimeve që në momente të caktuara kanë ndikuar në inflacionin në tërësi.

Faktorët që kanë ndikuar në normën e inflacionit janë klasifikuar si faktorë me ndikim pozitiv ose negativ, me ndikim të përhershëm ose



të përkohshëm, me kah nga kërkesa apo nga oferta, të menjëhershëm apo të vonuar, me bazë spekulative ose objektive.

Ndër faktorët e përhershëm që veprojnë në formimin e normës mujore të inflacionit është veprimi i agregatëve monetarë dhe në veçanti i atij më likuid, **agregatit M1**. Studimet tona kanë treguar se inflacioni ndikohet nga zhvillimet monetare me një efekt prapaveprues për rreth tre muaj. Pas rritjes së lartë që pësoi M1 në muajt shkurt-prill, ai filloi të stabilizohet në vlera më të qëndrueshme duke pësuar rritje të vogla në muajt maj dhe qershor, derisa në muajin korrik dhe në vazhdim shënoi reduktim të lehtë. Ky fakt ka ndikuar në normalizimin e ushtrimit të presioneve inflacioniste.


Grafik 1.: Ndryshimet vjetore të në përqindje të Agregatit Monetar M1 dhe Parase Jashte Bankave

Kursi i këmbimit, si një faktor tjetër me veprim të përhershëm, nuk ka ushtruar presione të forta inflacioniste pas gjysmës së parë të vitit. Lëvizja simetrike e kursit të këmbimit duke filluar nga muaji maj ka ndikuar në balancimin e presioneve të kursit të këmbimit të lekut kundrejt këtyre dy monedhave në inflacion. Këtë e tregon ecuria e inflacionit gjatë periudhës maj-tetor, gjatë së cilës çmimet kanë qenë relativisht të qëndrueshëm kundrejt periudhës janar-prill.

Grafik 2.: Ndryshimet vjetore të kursit të këmbimit lek/usd dhe lek/euro.

Shpenzimet buxhetore kanë vijuar të jenë të tkurrura gjatë gjysmës së dytë të vitit duke pasqyruar edhe mungesën e likuiditetit në sistemin bankar. Plani tetëmujor i shpenzimeve buxhetore është realizuar në masën 88 për qind. Kjo ka ndikuar në zbutjen e presioneve inflacioniste, në mënyrë të veçantë duke filluar nga muaji prill e në vazhdim.

Normat e inflacionit të vendeve partnere kryesore tregtare me Shqipërinë, kanë regjistruar shifra më të larta se pritshmëritë. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e çmimeve të mallrave të importuara, duke filluar nga muaji shtator, muaj kur importet fillojnë të gjallërohen pas rënies së prodhimit në stinën e verës. Kështu, inflacioni në vendet e Eurozonës vazhdon të jetë më i lartë sesa parashikimi prej 2 për qind në nivel vjetor, duke shënuar një vlerë prej 2.3 për qind në muajin tetor. Në Itali, partneri kryesor tregtar i Shqipërisë, inflacioni vjetor ishte në nivelin 2.7 për qind. Inflacioni vjetor në tetor në vendin tjetër fqinj, Greqinë, arriti në 3.7 për qind dhe inflacioni vjetor mesatar 3.6 për qind.. Mekanizmi i transmisionit



shpjegon se mbiçmimi i euros dhe afrimi i vlerës së tij në shkëmbim me lekun afër vlerës së dollarit ka sjellë importe më të shtrenjta, në një ekonomi shqiptare ku 78 për qind e shkëmbimeve tregtare kryhet me Eurozonën dhe 65 për qind kryhet me ato vende anëtare të Eurozonës ku ka inflacion më të lartë, Itali dhe Greqi.

Mungesa e energjisë elektrike është kthyer tashmë në një faktor të përhershëm që ndikon mbi normën e inflacionit. Kështu, ndërsa stabilizimi i situatës energjitike në muajt prill e maj ndikoi në uljen e normës së inflacionit në muajt maj e qershor, mungesat që erdhën duke u rritur në muajt e tjerë (edhe gjatë muajve të verës) ndikuan në kahun negativ në rritjen e normës së inflacionit. Megjithatë, duket se qeveria po zbaton një politikë më të kujdesshme për ruajtjen e rezervave ujore, për të minimizuar një krizë të rëndë energjitike dimrin që po vjen. Ky faktor ka ndikim psikologjik në kahun rritës të inflacionit, sa herë që jepen shenjat e para të një krize energjitike. Në mënyrë të veçantë këtë vit kufizimet e energjisë elektrike shkaktuan drejtpërdrejt rritjen e çmimit të naftës dhe në mënyrë të tërthortë edhe të shërbimeve.

Ndër faktorët specifikë kryesorë që kanë vepruar këtë vit përmendim:

Klima e favorshme politike, në mënyrë të veçantë pas korrikut të këtij viti, nuk ka vepruar në kahun rritës për inflacionin lidhur me faktorët psikologjikë dhe në përgjithësi në pritjet inflacioniste.

Dëmet nga përmbytjet, prekën sektorin e bujqësisë në një masë rreth 2 miliardë lekë. Sipërfaqet e tëra të përmbytura, si edhe dëmtimet në blegtori, vlerësohet të ulin prodhimin e brendshëm bujqësor për vitin 2002 dhe në vijim. Për pasojë, kjo vlerësohet si një indikator i mjaftueshëm, që në një farë mënyre do të sjellë mungesa në tregun e brendshëm për produkte të vendit, por sidomos në vitin e ardhshëm. Këto mungesa në gjuhën e thjeshtë ekonomike përkthehen në rritje çmimesh dhe në shtimin e kërkesave për importe për prodhimet përkatëse. Për më tepër, fakti i fundit mund të shkaktojë rritje nga inflacioni i importuar. Mungesat në treg sjellin, në periudhat e rritjes konsumatore, siç ka treguar dhe historia e inflacionit, rritje të veprimeve spekulative, që rrisin çmimet deri në nivele absurde.

2. REAGIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË.

Në përgjigje të presioneve inflacioniste, por edhe për të nxitur kthimin e parasë në banka, pas ngjarjeve të mars – maj 2002, Banka e Shqipërisë ka shtrënguar politikën monetare. Kjo është konkretizuar me rritje të normave të interesit të Repove dy herë dhe në total të masën 1.5 pikë përqindjeje si dhe me sinjalizimin e vazhdueshëm se është e përshtatshme ruajtja ose shtrëngimi i mëtejshëm i politikës monetare. Nga ana tjetër, rritja e normave të interesit ka ndihmuar në kthimin e parave në sistemin bankar si edhe ka zbutur presionet inflacioniste, me efekt më të plotë në gjysmën e dytë të vitit. Kështu, depozitat me afat kanë pësuar rritje duke filluar nga muaji korrik dhe në muajin shtator pësuan një rritje të konsiderueshme prej 3.4 miliardë lekësh.

Një tjetër element nxitës ka qenë edhe rritja e interesave realë dhe e diferencës së interesave në lekë me ato në valutë, diferencë e cila është zgjeruar më tej edhe si pasojë e reduktimit të interesave në valutë në tregjet ndërkombëtare. Këto lëvizje rrisin më tej interesin për të monedhën e vendit.

3. PRITSHMËRITË PËR INFLACIONIN

Siç u theksua më sipër, ende synojmë që në fund të vitit të arrihet norma e inflacionit afër 4 për qind. Kjo për arsye se:

- **Ecuria e agregatëve monetarë** ka qenë e tillë që ka zbutur presionet për rritjen e inflacionit. Si pasojë e kapërcimit të problemeve me likuiditetin të shkaktuara nga tërheqja e depozitave dhe fillimi i kthimit të parasë në sistem, madje me ritme të kënaqshme gjatë muajit tetor, elementi më likuid i ofertës së parasë ka reduktuar ritmin e rritjes;

- **Ulja e interesit të depozitave në dollarë amerikanë nga bankat e sistemit**, do të çojë në uljen e mëtejshme të të ardhurave nga interesat për to. Interesat për depozitat në euro nuk pritet të

pësojnë ndryshime. Interesat në lekë pritet të ruajnë nivelet aktuale me luhatje të lehta në rritje nga banka të veçanta. Niveli i pritshëm i interesave në tregun e brendshëm, pritet të favorizojë monedhën vendase, duke shërbyer si nxitje për rritjen e kursimeve në lekë.

- **Ecuria e kursit të këmbimit**, në muajin tetor nuk paraqet rrezikshmëri për rritjen e inflacionit të muajit nëntor. Mbiçmimi i lekut ndaj dy monedhave të huaja, nuk flet për ushtrimin e presioneve inflacioniste nga kursi i këmbimit. Leku është mbiçmuar disi kundrejt dollarit dhe ka patur një nënçmim të lehtë kundrejt euros gjatë gjysmës së parë të muajit nëntor. Duke u nisur nga kjo, dhe nga mbiçmimi i vërejtur gjatë viteve të fundit në muajin dhjetor, nuk presim që kursi i këmbimit të japë ndikim në rritjen e inflacionit në fundin e vitit.

Përveç faktorëve të mësipërm në kahun negativ pritet të veprojnë këto faktorë:

Inflacioni i importuar, pasi pritet që në Eurozonë inflacioni të mos reduktohet, madje një partner kryesor tregtar, Greqia, pret të ketë një inflacion prej 3.4 për qind në fund të dhjetorit dhe inflacion mesatar vjetor prej 3.6 për qind.

- Kanë filluar përsëri **ndërprerjet e energjisë elektrike**, të cilat kanë qenë dhe shkak kryesor për një ecuri jo të mirë të degës së industrisë në vend dhe që ka ndikuar në reduktimin e objektivit për rritjen e ekonomisë.

- **Prodhimi bujqësor nuk pritet të japë kontributin e planifikuar** në rritjen e PBB-së. Në këto kushte muajt në vijim do të ketë një prodhim më të ulët bujqësor dhe blektoral vendas. Kjo do të sjellë më pak prodhim vendas në treg, i cili do të zëvendësohet nga ai i importuar, pra edhe çmime më të larta, për shkak të inflacionit të importuar. Po kështu do të kemi prodhime agroindustriale "më të shtrenjta", për shkak të përdorimit më të pakët të produkteve vendase, "më të lira", në procesin e prodhimit.

- **Veprimi i faktorëve spekulativë** i cili shfaqet me intensitet në prag të festave të fundvitit. Tashmë është e verifikuar se çmimet e fundvitit, dhe për pasojë edhe objektivi për inflacionin, janë të kërcënuar nga efektet spekulativë të rritjes së çmimeve. Ky spekulim po merr tiparin e një faktori me veprim sezonal në inflacion me veprim në kahun rritës. Më i dukshëm ky "sezonalitet" shfaqet në grupin e mallrave të tregtueshëm.

3. PLAN VEPRIMI I BSH-SE PËR TË REDUKTUAR VEPRIMIN E FAKTORËVE SPEKULATIVË

Spekulimi me çmimet në fund të vitit është një fenomen i cili është bërë mjaft i dukshëm në tre vitet e fundit dhe madje intensiteti i tij ka ardhur duke u rritur. Duke qenë se ai ndikon drejtpërdrejt në një nga treguesit kryesorë të ekonomisë, çmimet e konsumit, Banka e Shqipërisë ka ideuar një plan veprimi për të reduktuar veprimin e faktorëve të tillë në treg. Sigurisht që nuk pritet që rezultatet të jenë maksimale qysh këtë vit. Megjithatë, ky plan veprimi do të na ndihmojë që për një periudhë afatmesme të sigurojmë efektet e dëshiruara.

Kjo fushatë ka dy elemente bazë:

- bashkëveprimin me Qeverinë Shqiptare dhe institucionet e tjera përkatëse;
- edukimin e popullsisë por edhe të bizneseve për të modeluar sjelljet e tyre me qëllim që të mos bëhen mbështetës të spekulimit.

Bashkëpunimi me Qeverinë Shqiptare është i nevojshëm për të reduktuar sa më shumë të jetë e mundur ata faktorë që ndikojnë në rritje çmimesh në fund të vitit. Në tërësi, periudha e dimrit shoqërohet me rritje çmimesh si pasojë e motit të ftohtë që shoqërohet me krijimin e rezervave ushqimore, ndjehet më e plotë kriza energjitike si dhe rritet importi i mallrave në përgjigje të uljes së prodhimit të brendshëm. Përveç këtyre faktorëve, Banka e Shqipërisë

mendon që organet e pushtetit qendror e vendor mund të angazhohen konkretisht për reduktuar spekulimin me çmimet. Masat të cilat mund të merren dhe bashkërendohen në këtë drejtim kanë të bëjnë me:

- Publikimin e çmimeve. Nga autoritetet përkatëse në mënyrë të rregullt ditore gjatë muajit dhjetor mund të publikohen çmimet e importeve të mallrave apo ato të tregut të shumicës dhe të pakicës. Në këtë mënyrë, identifikohet spekuluesi dhe madhësia e spekulimit. Mbi këtë bazë, organet e tatimeve kanë mundësi të ndjekin diferencat e çmimeve dhe të llogarisin më mirë detyrimet fiskale të bizneseve.

- Ruajtja e një ritmi harmonik në kryerjen e shpenzimeve buxhetore. Grumbullimi i tyre në fund të vitit dhe sidomos zbatimi i praktikës së parapagimeve, krijon kushte për të rritur çmimet edhe për shkak të iluzionit të pasjes së më shumë parave në dispozicion.

- Ruajtja e një ritmi harmonik në grumbullimin e të ardhurave. Muaji dhjetor nuk duhet të shndërrohet në muaj me aktivitet intensiv të organeve tatimore-doganore për mbledhje të ardhurash me qëllim përmbushjen e detyrave të planifikuara. Në këtë mënyrë penalizohen padrejtësisht bizneset, sidomos nëse nga organet tatimore do të kërkohen parapagime të detyrimeve në tatim-taksa.

- Dhënien e shtrirë në kohë (jo të përqendruar në fund të muajit dhjetor) të shpërblimeve për punonjësit e administratës shtetërore apo pagat shtesë për arsimtarët gjë që lejon dhe rritje graduale të kërkesës nga këto grupe të popullsisë duke mos krijuar një kërkesë të rritur artificiale në fund të vitit.

Po kështu, mund të studjohet nëse ka hapësira të tjera ligjore të cilat u mundësojnë organeve shtetërore qendrore dhe të pushtetit vendor të mos lejojnë rritje të pajustificuar çmimesh nga ana e tregtarëve.

Në planin afatmesëm do të ndihmonte forcimi i autoritetit të mbrojtjes së konsumatorit dhe nxitjes së konkurrencës në tregje si dhe forcimi i zbatimit të ligjit dhe të kuadrit rregullativ përkatës.

Në tërësi, për masat që do të merren do të ishte e dobishme që të kishte prononcime dhe njoftime publike të vazhdueshme.

Ndërgjegjësimi i publikut për të mos reaguuar me rritje artificiale të kërkesës për mallra. Ndoshta për traditë në Shqipëri blihet me tepri mall në prag festash dhe kërkesa kthehet në inelastike. Kjo do të thotë që pavarësisht nga oferta e shtuar, çmimet rriten. Ndërgjegjësimi i publikut për këtë çështje do të synohet nëpërmjet mediave si mjet më i shpejtë dhe më efikas dhe në këtë rast do të kërkonim ndihmën tuaj të vlefshme dhe të mirëpritur.

Banka e Shqipërisë sugjeron se do të ishte e vlefshme mbështetja juaj nëpërmjet botimit të shkrimeve, bërjes së intervistave dhe ndjekjes së çmimeve të tregjeve. Po kështu, pasqyrimi sa më i saktë dhe i gjerë i të gjitha aktiviteteve që do të bëjë Banka e Shqipërisë për këtë çështje.

Së fundi, duhet të jetë e qartë që edhe bizneset vetë përfitojnë nga reduktimi i spekulimeve në tregje. Pavarësisht se në plan afatshkurtër duket sikur ata do të arkëtojnë më pak para nëse nuk i rrisin në mënyrë artificiale çmimet, në plan afatgjatë do të ketë përfitime pasi stabilizimi i çmimeve sjell më tepër siguri për vendimet e tyre të investimit dhe të zgjerimit të aktivitetit. Të gjitha këto elementë janë të dobishëm për t'u trajtuar në mënyrë intensive në median shqiptare.